



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 27 maj 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i Vendimit mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtës i Hashim Thaçit**  
Dejvid Hupër

**Mbrojtës i Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtës i Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëse e Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzues Pune”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 prill 2020, Prokurori i Specializuar parashtroi për konfirmim një aktakuzë (“Aktakuza”) konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialin provues që mbështet faktet materiale mbi të cilat janë ngritur akuzat dhe një përmbledhje që tregon lidhjen e secilës provë me secilën akuzë.<sup>2</sup>

2. Më 22 maj 2020, Prokurori i Specializuar, në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës,<sup>3</sup> kërkoi tejkalinimin e fjalëve të lejuara prej 9,000 fjalësh në mënyrë që të bëjë parashtrime të njëmendta lidhur me arrestimin dhe transferimin e të dyshuarve të përmendur në Aktakuzë dhe masat përkatëse (“Kërkesa”).<sup>4</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në përputhje me nenin 41 të Udhëzuesit të Punës, mocionet nuk duhet të tejkalojnë numrin e fjalëve të lejuara prej 6.000 fjalësh.

4. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, pjesëmarrësit në procedime mund të kërkojnë mjaftueshmërisht në kohë tejkalinimin e fjalëve të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim*, 25 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> Udhëzim Pune i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC-BD-15), 17 maj 2019.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00003, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për tejkalinimin e numrit të fjalëve të lejuara (“Kërkesa”)*, 22 maj 2020, para. 2.

lejuara pasi të kenë treguar se ekzistojnë arsye bindëse që përbëjnë rrethana të posaçme.

### III. DISKUTIM

5. Prokurori i Specializuar synon të bëjë parashtrime të shumëfishta në lidhje me arrestimin dhe transferimin e katër të dyshuarve të përmendur në Aktakuzë, kontrollimin dhe sekuestrimin, [REDAKTUAR] dhe mosnxjerrjen e Aktakuzës dhe materialit të lidhur me të.<sup>5</sup>

6. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se kërkesa për tejkalimin e fjalëve të lejuara u parashtrua mjaftueshmërisht në kohë në rrethanat aktuale, sepse nuk ka afat për parashtrimin e kërkesave të paralajmëruara nga Prokurori i Specializuar në Aktakuzë.

7. Në lidhje me kriterin për arsye bindëse, duke marrë parasysh numrin e parashtrimeve që do të bëhen, kompleksitetin e çështjeve të përfshira dhe nevojën për të parashtruar në hollësi të mjaftueshme faktet, argumentet dhe provat mbi të cilat bazohen parashtrimet e përmendura, si dhe numrin e të dyshuarve me të cilët lidhen ato parashtrime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në rastin aktual ekzistojnë arsye bindëse që përbëjnë rrethana të posaçme për arsyetimin e kërkesës për tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve. Rrjedhimisht, kërkesa miratohet.

---

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 2. Këto parashtrime tashmë janë paralajmëruar në Aktakuzë, para. 5.

IV. VENDIM

8. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, Gjykatësi i Procedurës

Paraprake:

**Miratton** kërkesën.

\_\_\_\_\_/nënshkrim/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 27 maj 2020

Në Hagë, Holandë.